

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi-kryetar kolegji, Tonka Berishaj dhe Fllanza Kadiu, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Rezarta Lleshi, procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit M.G., nga fshati ..., komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale – falsifikim i parasë parashikuar me nenin 302 par.3 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtëses të të akuzuarit M.G., av. L.B.-I., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.158/2016 të datës 28.shkurt 2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së, me 28 mars 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të të akuzuarit M.G., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr. 158/2016 të datës 28.shkurt 2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr. 158/2016 të datës 28.shkurt 2017, të akuzuarin M.G., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale –falsifikim i parasë nga nenin 302 par. 3 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Me Aktvendimin e datës 16 mars 2017, kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 371 të KPPK-së ka bërë përmirësimin e aktgjykimi i Gjykatës

Themelore në Prishtinë, PKR.nr. 158/2016 të datës 28.shkurt 2017, për shkak të gabimit teknik sa i përket kohës së kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë:

- Mbrojtësja e të akuzuarit M.G., av. L.B.-I., për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par. 1.3 të KPPK-së dhe shkeljes së nenit 6 të Konventës Evropiane për drejta të njeriut me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta refuzojë aktakuzën.

- Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.156/17 të datës 22.03.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të të akuzuarit M.G., av. L.B.-I., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK-së, në mungesë të palëve sepse në këtë rast kemi të bëjmë me dënim me gjobë për çka nuk është e domosdoshme prania e palëve në procedurë.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, analizoi aktgjykimin e ankimuar, në kuptim të dispozitës së nenit 394 par 1 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Gjendja faktike e vërtetuar në aktgjykimin e shkallës së parë nuk ishte objekt i shqyrtimit sepse nuk ishte ankimuar, por në këtë rast as që lejohet ankesë për bazë ankimore nga neni 383 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, sepse të akuzuari e ka pranuar fajësinë për gjitha pikat e aktakuzës e me këtë është pajtuar edhe gjykata. Prandaj, kjo Gjykatë u përqendrua në vlerësimin e pretendimit ankimorë lidhur me shkeljet e ligjit penal e në kuptim të nenit 396 të KPPK-së edhe lidhur me vendimin për dënim.

Mbrojtësja e të akuzuarit me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është mare me shkelje të ligjit penal nga neni 363 par. 3 të KPPK-së që nënkupton edhe shkeljen e nenit 6 të Konventës Evropiane për drejtat e njeriut-për një proces të drejtë. Kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë edhe pse ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale nga neni 106 par. 1.6 të KPRK-së, është lëshuar në shqyrtimin gjyqësor edhe pse sipas detyrës zyrtare ka qenë i obliguar të verifikon afatin e parashkrimit dhe në këtë mënyrë e ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara për këto arsye:

Së pari, nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar, rezulton se i akuzuari M.G., është akuzuar për veprën penale –falsifikim i parasë parashikuar me nenin 302 par. 3 të KPRK për cilën veprë është përcaktuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Se dyti, sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 nën par. 1.6 të KPRK ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati prej dy (2) vitesh nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vit ose me dënim me gjobë. Ndërkaq me paragrafin 5 po të njëjtës dispozitë parashikohet se afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprimi cili ndermirët për qëllim të ndjekjes penale të veprës penale të kryer.

Në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e lëndës, vepra penale është kryer me dt. 14.03.2014, mirëpo prej kësaj kohe organet e ndjekjes si policia (sipas autorizimit të dhënë nga prokurori) ashtu edhe prokuroria gjatë vitit 2014 dhe 2015 kanë ndërmarrë veprime konkrete me qëllim të ndjekjes penale si: ekzaminimi i dëshmimeve, hetimet në drejtim të verifikimit të datës së lindjes të akuzuarit si dhe veprimet tjera të cilat e kanë ndërprerë afatin e parashkrimit. Prandaj, nga këto arsye kjo Gjykatë gjënë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar duke ndërmarrë veprime procedurale me qëllim të vendosjes së kësaj çështjeje, ndërsa pretendimet ankimore se në rastin konkret është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit për shkak se është arritur parashkrimi i ndjekjes penale të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, janë të pabazuara.

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk kundërshtohet për shkak të vendimit për dënim, Gjykata e Apelit duke vepruar sipas detyrës zyrtare konform nenit 396 të KPPK-së (efekti shtesë i ankesës së paraqitur për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose shkeljes së ligjit penal), aktgjykimin e shqyrtoi edhe në këtë drejtim dhe gjeti se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat për matjen e dënimit në pajtim me dispozitën e nenit 73 të KPRK.

Nga shkresat e lëndës, konkretisht nga aktgjykimi i ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese edhe atë: faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, ka shprehur pendim për veprën e kryer penale, faktin se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rrethana renduese nuk gjeti.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave, si të drejtë e pranon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe është në funksion të preventivës gjeneralë, posaçërisht të asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.152/2017, me date 28 mars 2017

Procesmbajtës,
Rezarta Lleshi

Kryetar i kolegjit,
1. Xhevdet Abazi

Anëtarët e kolegjit:

2.Tonka Berishaj

3.Fllanza Kadiu